



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2021

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: **“Blerimi” shpk** me adresë: Elbasan Shirgjan MJEKES Fshati Mjekes.Zona Topcias.

Procedura e prokurimit/lotit: **“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-06058-09-22-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksioni i objekteve arsimore"** me fond limit: **7,470,379** (shtatëmilion e katërqind e shtatëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) **lekë pa t.v.sh.** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2021, dhe me afat për kryerjen e punimeve **1 muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Blerimi” shpk me Nipt: J62903384G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **7.416.667** (shtatëmilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë** (pa tvsh).

2. “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6.638.494,60** (gjashtëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e tetëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër presje gjashtëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

“Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Bajrami-N

1. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.6. të kapacitetit teknik, pasi deklaratën që ka dorëzuar në SPE për stafin, nuk e ka dorëzuar te plote dhe sipas formatit të kërkuar nga AK në DST.

Operatori ka deklaruar që i disponon punonjësit e kualifikuar si teknikë ndërtimi, punonjës pllakashtrues, punonjës duroalumini dhe punonjës hidroizolues në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, por nuk ka plotësuar të dhënat e kërkuara nga AK sic janë kodi i deklarimit në listëpagesë referuar VKM nr.514 datë 20.09.2017 ”Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar, datën e fillimit të marrëdhënieve të punës, nr/amzës/ekuivalent diplomës/ çertifikatës profesionale si dhe nr. e çertifikatës së sigurimit teknik siç është përcaktuar në pikën 2.3.6. të kapacitetit teknik.

2. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik : Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë : Per materialet emulsion bitumi dhe leter katerma në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Autorizim te prodhuesit/ve ose distributorit/ve per prezantimin e materialeve te tyre ne oferte, Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. *Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit.*

Operatori ekonomik ka dorëzuar në SPE kontratë paraprake furnizimi me shoqërinë "Amos OIL" sh.p.k. për furnizimin me bitum dhe lëtër katërma në rast se OE shpallet fitues, si dhe ka dorëzuar fragment të katalogut të specifikimeve teknike vetëm për bitumin (cut back bitumen), por, asnjë katalog apo fragment për letrën e katërmasë.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Blerimi” shpk** me adresë: Elbasan Shirgjan MJEKES Fshati Mjekes.Zona Topcias se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **7.416.667** (shtatëmilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari
Irland Sina**